


FATURA E PAPAGUAR SHËNDETËSORE

Si na sëmurin neve termocentralet me qymyr në KOSOVË



HEAL

Promoting environmental policy
that contributes to good health



Kjo fletë faktesh është pjesë e një raporti nga Health and Environment Alliance (HEAL) me titull "Fatura e papaguar shëndetësore – Si na sëmurin neve termocentralet me qymyr në Ballkanin Perëndimor" dhe jep një vlerësim të **ndikimit dhe kostos shëndetësore** që shoqëron **ndotjen e ajrit nga djegia e qymyrit dhe e linjtit në termocentralet ekzistuese në Kosovë**. Ajo llogarit gjithashtu kostot për termocentralet e planifikuara.

Dy termocentralet ekzistuese me qymyr krijojnë deri në 352 milionë EUR në vit kosto vjetore shëndetësore, nga të cilat 169 milionë EUR rëndojnë mbi popullatën brenda rajonit.

Termocentralet me qymyr emetojnë mijëra ton agentë ndotës të ajrit çdo vit, duke sjellë një kontribut të konsiderueshëm në ndotjen e ajrit në rajonin e Ballkanit dhe më gjerë. **Termocentralet ekzistuese në Kosovë shkaktojnë një total prej 70 deri në 169 milionë EUR në vit kosto shëndetësore për banorët dhe qeveritë në rajon. Për shkak të distancës së madhe të udhëtimit të ndotësve në ajër,** termocentralet në Kosovë i krijojnë Evropës një kosto totale shëndetësore prej 144 deri 352 milionë EUR në vit. Termocentralet në Kosovë punojnë kryesisht me standarde të ulëta mjedisore dhe krijojnë nivele të larta emetimesh ndotëse dhe ndikime të larta në shëndet.

A duhet vazhduar mbështetja te qymyri?

Në Kosovë, e cila aktualisht ka dy termocentrale ekzistuese – Kosova A dhe B - me një kapacitet të instaluar prej 1,4 GW, mund të instalohet një projekt i ri – Kosova C - me kapacitet 600 MW. Vitet e fundit, termocentrali Kosova A ka punuar me kapacitet më të ulët, sepse tre prej njësisve të saj nuk funksionojnë për shkak të problemeve teknike. Me vënien në funksionim të termocentralit të ri, njësitë ekzistuese do të mbyllën. Ndërtimi i Kosova C do të nënkuptonte se Kosova do të vazhdojë të mbështetet në formën më ndotëse të energjisë për shumë dekada të tjera.

Termocentrali i ri me qymyr, Kosova C - mund të shtojë kosto shëndetësore deri në 34 milionë EUR në vit

Termocentralet e rinj me qymyr në Kosovë dhe vende të tjera të Ballkanit Perëndimor duhet të operojnë sipas standardeve më të rrepta sesa sot për emetimet në ajër. Por, termocentrali i ardhshëm mund të rrisë koston shëndetësore prej 6 deri në 14 milionë EUR në vit për popullsinë në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Kjo mund të krijojë një kosto totale prej 14 deri 34 milionë EUR në vit për Evropën.

HEAL rekomandon që: Të rishikohen planet kombëtare të energjisë me qëllim që të reduktohet mbështetja te qymyri dhe në fund të nxirret gradualisht nga qarkullimi, si dhe të rriten investimet në energjinë e rinovueshme. Kjo përbën një mundësi të rëndësishme në parandalimin e ndikimeve shëndetësore në Kosovë.

Çfarë janë kostot e papaguara

Kjo fletë faktesh në nivel vendi, jep monetarizimin e ndikimeve të shëndeti të ndotjes së ajrit nga termocentralet me qymyr në Kosovë. Këto i quajmë "kosto të papaguara" ndaj shëndetit të njeriut sepse shpenzimet shëndetësore duhet të mbarten nga individët, familjet e tyre dhe shoqëria, dhe jo nga ata që janë përgjegjës për ndotjen.

Aktualisht, Kosova ka dy termocentrale me qymyr me katër njësi funksionale. Tre prej njërive të termocentralit Kosova A janë mbyllur së fundmi dhe një prej njërive funksionon me kapacitet më të ulët për shkak të problemeve teknike, prandaj kapaciteti aktual i punës është 888 MW. Në vitin 2014, avaritë teknike çuan në një shpërthim tragjik në Kosova A, ku një numër njerëzish humbën jetën.

Llogaritja e dëmit të termocentraleve me qymyr në Kosovë

Studimet e autorizuara për këtë fletë faktesh tregojnë se termocentralet me qymyr në Kosovë krijojnë kosto prej 70 deri 169 milionë EUR në dëme për shëndetin e qytetarëve në rajon.

Dëmet e shkaktuara ndaj shëndetit prej këtyre dy termocentraleve janë 144 deri 352 milionë EUR në vit. Kjo ndodh për shkak të erërave që e transportojnë tymin e qymyrit disa qindra kilometra duke shkaktuar ndotje të ajrit përtej kufijve.

Fatura e papaguar shëndetësore për termocentralet





Figura 1. Kostot e llogaritura shëndetësore nga termocentralet ekzistuese me qymyr ndaj popullsisë në Ballkanin Perëndimor dhe në Evropë (llogaritjet minimale dhe maksimale), në milionë EUR/vit

Shënim: Kostot shëndetësore që jepen për Ballkanin Perëndimor janë pjesë e kostove totale shëndetësore për Evropën, dhe për këtë shkak shifrat nuk mund të mbliidhen bashkë. Në këtë kontekst, Evropa përfshin 28 shtetet anëtare të BE-së plus Shqipërinë, Bjellorusinë, Moldavinë, Norvegjinë, Rajonet Perëndimore të Rusisë, Zvicrën, Ukrainën, Bosnjë e Hercegovinën, Kosovën, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë.

Kosova – vendi me disa prej termocentraleve me qymyr me ndotje më të lartë në Evropë

Ju prezantojmë dhjetë termocentralet me qymyr me ndotje më të lartë në Evropë¹



Nga të gjithë ndotësit e emetuar, më të dëmshmet për shëndetin janë grimcat PM_{2.5}. Kosova A dhe B janë emetuesit më të mëdhenj në Evropë me një total prej 7500 tonësh PM_{2.5} në vit. Këto njësi emetojnë katër herë më shumë PM_{2.5} sesa shumica e termocentraleve me qymyr në Ballkan dhe rekordin e emetimeve e mban njësisia 5 e termocentralit Kosova A që emeton nëntë

herë më shumë PM_{2.5} sesa mesatarja e termocentraleve të Ballkanit.

Termocentrali Kosova B është një prej emetuesve më të mëdhenj të gazeve NO_x në Ballkan, me 14 520 tonë në vit. Termocentrali emeton tre herë më shumë NO_x sesa mesatarja e termocentraleve të Ballkanit.

Cilat janë dëmet ndaj shëndetit?

Figura 2 më poshtë tregon dëmet ndaj shëndetit të shkaktuara nga ndotësit e ajrit të emetuar nga dy termocentralet me qymyr të Kosovës. Efekti më i rëndë jepet në krye (vdekja e parakohshme) dhe prek një numër të vogël të popullsisë, ndërsa efekti më pak i rëndë jepet në fund dhe prek një numër të madh personash (rastet e simptomave të rrugëve të poshtme të frymëmarrjes).

Ndikimi në shëndet dhe kostoja e shkaktuar nga prodhimi i energjisë nëpërmjet qymyrit në Kosovë




Figura 2. Faktorët që kontribuojnë në totalin e dëmeve të shkaktuara nga termocentralet me

Termocentralet e reja veçse do ta shtonin barrën shëndetësore

Kosova ka njoftuar ndërtimin e dy njësjive të reja – Kosova C - me kapacitet prej 600 MW, për të zëvendësuar termocentralet e vjetra ekzistuese. Ky termocentral i ri në Kosovë po mbështetet nga qeveria e Shteteve të Bashkuara dhe Banka Botërore. Por, ai është kundërshtuar fuqishëm nga komunitetet në vend, për shembull Shoqata e Pulmologëve të Kosovës. Interes dhe angazhim kundër termocentralit të ri të Kosovës kanë shprehur edhe lëvizjet globale si 350.org dhe SierraClub. Planet e vjetra

për termocentralin e ri ndryshojnë nga dita në ditë dhe duket se qeveria e Kosovës nuk ka një vizion të qartë se si do të vazhdojë më tej me një strategji të shëndetshme energjetike. Nëse realizo-hen planet për termocentralin e ardhshëm me qymyr me kapacitet 600 MW, kostoja shëndetësore shtesë mund të arrijë deri në 34 milionë EUR në vit. Brenda kësaj shifre, 6 deri 14 milionë EUR në vit është kosto shëndetësore për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Fatura e papaguar shëndetësore për termocentralin e ardhshëm Kosova C në Kosovë



Figura 3. Kosto e llogaritura shëndetësore nga termocentrali i ri i planifikuar, ndaj popullsisë në Ballkan-in Perëndimor dhe në Evropë (llogaritjet minimale dhe maksimale), në milionë EUR/vit

Për shkak të standardeve më të larta të parashikuara për kontrollin e ndotjes për termocentralin e ri, kostoja shëndetësore do të jetë relativisht më e ulët. Termocentralet e reja me qymyr duhet të jenë në pajtim me legjislacionin e BE-së. Ky është një lajm i mirë për shëndetin, sepse u duhet të përdorin "teknologjitë më të mira të disponueshme" për të filtruar ndotësit nga ajri. Detyrimet e Kosovës për të qenë në pajtim me standardet e rrepta të emetimeve në ajër janë rezultat i anëtarësimit të saj në Komunitetin e Energjisë, një organizatë ndërkombëtare që merret me politikën e energjisë.

Kosova ka objektiva të detyrueshme kombëtare për të arritur 25 përqind të energjisë përmes përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë deri në vitin 2020. Kjo duhet të përfshijë nxjerrjen graduale të qymyrit nga përdorimi dhe zgjedhjen e energjive të rinovueshme, të cilat janë të shëndetshme dhe shumë më ekologjike.

E ardhmja: zgjedhjet e shëndetshme energjetike



REKOMANDIMET E POLITIKËS PËR VENDIMARRËSIT KOSOVARË ATA DUHET >>>>

- **Të nxjerrin me shpejtësi nga përdorimi qymyrin: Të mbyllin të gjitha termocentralet e vjetra me qymyr dhe të mos ndërtojnë të reja;**

HEAL është e mendimit se një nxjerrje graduale e prodhimit të energjisë nga qymyri për BE-në është e mundur deri në vitin 2040. Kosova duhet të arrijë dekarbonizimin e sektorit të energjisë brenda të njëjtës periudhe kohore.

- **Të marrin në konsideratë mbrojtjen e shëndetit në të gjitha vendimet rreth energjisë dhe të zgjedhin energjitë e rinovueshme dhe kursimet e energjisë;**
- **Të përafrojnë legjislacionin kombëtar me rekomandimet e OBSH-së dhe të implementojnë plotësisht ligjet ekzistuese për ajrin me qëllim që të merren përgjegjësitë për të siguruar ajër të pastër për frymëmarrjen e popullsisë vendase dhe;**
- **Të plotësojnë detyrimet dhe të implementojnë plotësisht standardet e rëna dakord në traktatet ndërkombëtare, të tilla si Komuniteti i Energjisë, Protokoli i Kiotos dhe Traktati i Parisit.**

PROFESIONISTËT E SHËNDETIT DUHET TË FLASIN RRETH KOSTOVE TË PAPAGUARA SHËNDETËSORE

Profesionistët e shëndetit dhe të mjekësisë kanë një rol unik në inkurajimin e tranzicionit nga ndotja te format e shëndetshme të energjisë në Kosovë. Ata duhet të vazhdojnë debatet rreth opsioneve të energjisë së shëndetshme me ministrinë e shëndetësisë, ministrinë e energjetikës dhe institucione të tjera qeveritare, si edhe me publikun. Publikimi dhe sensibilizimi për kostot reale të gjenerimit të energjisë nga qymyri do të sjellë përfitime për shëndetin publik.

Referencat

¹ Të dhëna mbi emetimet për termocentralet ekzistuese, shih "Shikim i shpejtë i metodologjisë" në skedarin kryesor të raportit "Fatura e papaguar shëndetësore – Si na sëmurin neve termocentralet me qymyr në Ballkanin Perëndimor".

² https://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/AREAS_OF_WORK/Obligations/Renewable_Energy

Rreth HEAL

Health and Environment Alliance (HEAL) është një organizatë kryesuese evropiane jofitimprurëse që i adresohet mënyrës se si mjedisi ndikon te shëndeti në Bashkimin Evropian (BE). Me mbështetjen e mbi 70 organizatave anëtare, HEAL sjellë përvojë dhe prova të pavarura nga komuniteti i shëndetësisë për procese të ndryshme vendimmarrëse. Aleanca jonë e gjerë përbëhet nga profesionistët të shëndetit, ente siguruese shëndetësore jofitimprurëse, doktorë, infermierë, grupe të kancerit dhe të astmës, qytetarë, grupime të grave, grupime rinore, OJQ mjedisore, shkencëtarë dhe institucione kërkimore të shëndetit publik. Anëtarët përfshijnë organizata ndërkombëtare dhe mbarë-evropiane, si edhe grupe kombëtare dhe vendore.



Botuesi përgjegjës: Genon K. Jensen, Drejtor Ekzekutiv, HEAL

Kryeautore dhe studiuese: Vlatka Matković Puljić, Drejtoreshë e Shëndetit dhe e Energjisë, Rajoni i Ballkanit (HEAL)

Raporti teknik: Mike Holland, Ecometrics Research and Consulting (EMRC)

Stafi këshillues dhe analizues: Anne Stauffer, Zëvendës Drejtoreshë, HEAL; Diana Smith, Këshilluese e Komunikimeve, HEAL; dhe Lucy Mathieson, Drejtoreshë e Komunikimeve, HEAL

Dizajni: Lies Verheyen, www.mazout.nu

Shtypja: Shtypur në letër me përbërje 100% mbetjesh post-konsumatore me bojëra me bazë vegjetale

Publikuar në mars 2016



HEAL shpreh mirënjohjen e saj për mbështetjen e Fondacionit Evropian të Klimës (FEK) dhe të Bash-kimit Evropian (BE) për prodhimin e këtij publikimi. Përgjegjësia për përmbajtjen u përket autorëve dhe pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk reflektojnë me domosdoshmëri pikëpamjet e in-stitucioneve të BE-së dhe të financuesve.